

# **STAUTI I SHOQERISE DHE AKTI I THEMELIMIT**

## **TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

### **“ S.M.A.R.T CONNECT SH.P.K”**

**(Hartuar ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008,“Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”)**

#### **Shtetasi :**

Agjelos Çumani, i biri i Roland, i datelindjes 24/08/1999 ,me nr personal J90824006D, lindur ne Greqi dhe banues ne Tirane, Rr.Sotir Caci, Pallatet Delta, qytetar shqiptar, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, krijon Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “S.M.A.R.T CONNECT”Sh.P.K me seli ne Rr: Artan Lenja, Kompleksi Kontakt, Godina Lyra, Tirane.

Statuti eshte akti baze ku do te mbeshtetet themelimi i shoqerise “S.M.A.R.T CONNECT ” sh.p.k si dhe zhvillimi i metejshem i saj.

#### **KREU 1**

#### **NENI 1**

#### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

1.1 Ortaku i vetem i shoqerise eshte Agjelos Çumani i lindur me 24/08/1999 ne Athine,Greqi, me banim ne Tirane, identifikuar me ane te kartes se identitetit J90824006D ,madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i cili zoteron 100% te kapitalit te shoqerise.

#### **NENI 2**

#### **EMERTIMI I SHOQERISE**

2.1 Shoqeria eshte quajtur “S.M.A.R.T CONNECT” shpk.

Ajo eshte subjekt juridik shqiptar dhe ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne aktin e themelimit dhe statutit,si dhe ne kontratat respektive.

Ortaku themelues ne kete sipermarrje ka derdhur kapitalin e tij me qellim qe te perfitoje te ardhura, qe mund te vijne nga ushtrimi i veprimtarise private. Ai perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se derdhur ne kapitalin themelor.

### **NENI 3**

#### **SELIA E SHOQERISE**

3.1 Shoqeria “ **S.M.A.R.T CONNECT** ” sh.p.k. e ka seline e saj ne Tirane ne adresen, Rr: Artan Lenja, Kompleksi Kontakt, Godina Lyra, Tirane

3.2 Ajo ka te drejte te krijojte brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise, filiale, agjensi perfaqesimi, seli sekondare si dhe ti suprimoje ato.

### **NENI 4**

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

4.1 Objekti i aktiviteti ekonomik te shoqerise eshte **Telemarketing**.

4.2 Aktiviteti do te realizohet duke respektuar legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, te miratuar nga ortaku i vetem i saj.

4.3 Shoqeria mund te zgjeroje ose kufizojte fushen e veprimtarise se saj ne cdo kohe.

### **NENI 5**

#### **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

5.1 Shoqeria tregtare “ **S.M.A.R.T CONNECT**” sh.p.k do te kete nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike me nje afat te pacaktuar nga data e regjistrimit te saj.

5.2 Si date e fillimit te saj merret data e regjistrimit prane Qendres Kombetare te Biznesit.

## **NENI 6**

### **PERGJEGJESIA E ORTAKUT TE VETEM**

6.1 Pjesemarrja ne shoqeri nuk pengon pavaresine ligjire,organizative dhe te pronesise se ortakut te vetem.

6.2 Ortaku i vetem qe merr pjese ne kete shoqeri nuk eshte pergjegjes per detyrimet qe lindin gjate aktivitetit tregtar te shoqerise ,pertej kapitalit themeltar te saj,qe ai vete ka nenshkruar,gjithashtu shoqeria nuk pergjigjrt per detyrimet personale te ortakut te saj.

## **NENI 7**

### **SIMBOLET E SHOQERISE**

7.1 Shoqeria do te kete vulen e saj “ S.M.A.R.T CONNECT” sh.p.k

## **KREU II**

### **NENI 8**

8. Kapitali i shoqerise eshte 10.000 (dhjetemije) leke, i cili perbehet nga :

8.1 Kapitali para me vlere te barabarte me 10.000(dhjetemije) leke.

Ortaku i vetem i shoqerise,Agjelos Cumani zoteron 100% te kapitalit te shoqerise.

8.2 Kapitali i shoqerise mund te ndryshoje sipas vendimit qe do te marre Ortaku i Vetem, ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”.

## **NENI 9**

### **TRANSFERIMI I KAPITALIT DHE KUOTAVE**

9.1 Kapitali themeltar ose pjese te vecanta te tij, jane te transferueshme nga ortakut tek te tretet.Transferimi i kapitalit ose pjeseve te tij nga ortakut i vetem ne favor te te treteve,kryhet gjithnje me akt noterial te posacem.

9.2 Shoqeria mund te rrisi kapitalin themeltar ose mund ta zvogeloje ate,por gjithnje jo nenkufirin e 100.000 (njqqindmije) leke.Zmadhmi dhe zvogelimi i kapitalit behet me vendim te ortakut te shoqerise dhe sipas parashikimeve te ligjit nr 9901,date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare.

9.3 Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre dhe ne sherbime,nepermjet

emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kerkeses se administratorit.

9.4 Kapitali i shoqerise mund te zvogelohet me vendim te Ortakut te Vetem ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

9.5 Vendimi per zvogelimin e kapitalit i njoftohet Qendres Kombetare te Biznesit per regjistrim nga administratori,ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr.9723,date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit".

## **NENI 10 TRANSFERIMI I KUOTAVE**

10.1 Kuotat e kapitali te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes
- c) trashgimise
- d) dhurimit
- e) cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj

10.2 Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

10.3 Kalimi i kutove kushtezohet nga e drejta e parablerjes se tyre nga ortaket e tjere te shoqerise.

## **KREU III NENI 11 ORGANI VENDIMARRES**

11.2 Organi vendimarrës i shoqerise eshte Ortaku i Vetem.

11.3 Ortaku i Vetem ka te drejte per te vendosur per ceshtje te tilla si:

- Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- Emerimi ose shkarkimi i administratoreve, eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve;
- Miratimi i raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive, ndarja e fitimit;
- Zvogelimi i kapitalit themelor ose zmadhimi i tij;
- Transferimi i pjeseve te kapitalit themelor te te tretet

- Zgjatja e afatit të veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj;
- Shndërrimi i shoqërisë në një formë tjetër, në një nga format e parashikuara nga ligji;

## **NENI 12**

### **ADMINISTRATORI**

12.1 Shoqëria administrohet nga Z. Agjelo Çumani.

12.2 Administratori qëndron për një periudhë 5 vjeçare në detyrë, me të drejtë rizgjedhjeje.

Ortaku i Vetëm gëzon të drejtën në çdo kohë të shkarkojë nga detyra administratorin dhe të emerojë një tjetër në vend të tij.

## **NENI 13**

### **KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJESITË E ADMINISTRATORIT**

13.1 Administratori ka këto kompetenca:

- Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga ortaku.
- Perfaqëson shoqërinë tregtare.
- Kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të librave kontabel të shoqërisë.
- Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor të shoqërisë, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimit të cilat i paraqiten ortakut për miratim.
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.
- Administratori ka të drejtë që të çeli llogari bankare dhe të kryejë veprime pranë bankave të të gjitha niveleve kudo ku shoqëria disponon llogari bankare, ato mbeten përgjegjësi e ortakut.
- Administratori ka të gjitha kompetencat për të punësuar personelin e shoqërisë duke respektuar dispozitat e Kodit të Punës.
- Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.

- Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridikë, publike dhe/ose privatë vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.
- Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakut.
- Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

#### **NENI 14**

##### **VITI FINANCIAR**

Cdo vit financiar fillon me 1 janar te cdo viti dhe perfundon me 31 dhjetor, me perjashtim te vitit te pare ku si fillim eshte data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit.

#### **NENI 15**

##### **BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET**

15.1 Miratimi i dokumentave financiare vjetore behet brenda nje afati 3-mujor, mbas dates se mbylljes se vitit financiar

15.2 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme, e perbere nga Ortaku i vetem ,vendos rreth shperndarjes se dividendit,pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar,sic parashikohet nga ligji.

#### **NENI 16**

##### **MBARIMI I SHOQERISE**

16.1 Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b) me vendim te Ortakut te Vetem
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit

d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr 9723,date 3.5.2007 “ Per Qendren Kombetare te Biznesit.

e) me vendim te gjykates

16.2 Ne kete rast ,Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ,ne te cilen parashikon menyren e likuidimit te shoqerise,duke caktuar nje apo disa likuidues dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuiduesit dhe emertesën shtese “Shoqeri ne likuidim e siper”.

16.3 Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese ,me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

16.4 Nese Ortaku i Vetem nuk merr nje vendim per emerimin e likuiduesve,brenda 30 diteve pas prishjes,cdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

## **NENI 17**

### **TRANSFORMIMI I SHOQERISE**

17.1 Transformimi i shoqerise behet me vendim te Ortakut te Vetem ose kur ekzistojne faktore te jahtem detyrues ligjoree, ne keto raste vendimi merret pasi eshte paraqitur nje raport mbi gjendjen e shoqerise nga ana e administratorit.

17.2 Cdo transformim i bere ne kundershtim me kete nen eshte i pavlefshem.

## **NENI 18**

### **BAZA LIGJORE**

18.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

18.2 Ceshtjet e tjera qe nuk trajtohen ne kete statut zgjidhen ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” Ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” , i ndryshuar, si dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

## **NENI 19**

### **MOSMARREVESHJET**

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, do t’i kalojne ne kompetence Gjykates.



**NENI 20**

**DISPOZITA PERFUNDIMTARE**

20.1 Ky statut eshte hartuar me vullnetin e lire dhe teplote te Ortakut te Vetem dhe eshte nenshkruar prej tij.

20.2 Ky Statut eshte perpiluar dhe firmosur ne kater kopje me vlere te njejte me originalin.

Nje kopje mbahet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

**ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQERISE**

**"S.M.A.R.T CONNECT" sh.p.k**

Aqselos Gumani



14.01.2022